

INTERVISTË ME DEPUTETIN E POGRADECIT, Z. FATBARDH KADILLI

# Mokrarëve u kam borxh besimin, besën

Një nga 6 deputetët e PD-së për qarkun e Korçës, i zgjedhur me votën e lirë të popullit, Fatbardh Kadilli përfaqëson sot Pogradecin dhe Mokrën në Parlamentin shqiptar. Me një karrierë të suksesshme, gjithë një ngritje Kadilli politikani i ri i të sotmes dhe të nesërmes, për herë të parë çon në Kuvend zërin e mokrarëve, amanetin e gjyshërve dhe të afërme të tij që e nesërmja të jetë më e mirë. Për të kjo detyrë është "një përgjegjësi e madhe dhe jo një privilegj. Por, përfaqësimi është në radhë të parë besim. Jam i bindur që të gjithë ata që kanë përfaqësuar Mokrën kudo, kanë ndjerë të njëjtën krenari që ndjej edhe unë sot si përfaqësues i një krahine dhe një populli që nderohet kudo në Shqipëri."

E kënaqësi ai pranoi ftesën tonë për këtë intervistë duke shpalosur edhe projektet, dëshirat dhe ambiciet e tij, ku pa dyshim, rruga e Mokres, eshte objektivi me i madh i mandatit te tij dhe te qeverise e partise qe ai perfaqeson. Kjo është e para intervistë e tij, por jo e fundit. Duke shprehur falenderimin dhe mirenjohjen, sigurojme se faqet e gazetës janë të hapura për të dhe këdo që mendon mirë e punon për Mokrën, për të ardhmen e saj.



"...Sa i përket Mokrës projekti më i rëndësishëm dhe që do t'ia ndryshojë faqen Mokrës është ai i ndërtimit të rrugës Qukës-Ploçë. Ky është investimi publik më i madh në historinë e Mokrës, ndoshta që nga koha e romakëve që ndërtuan Via-Egnatia, një segment i të cilës thuhet se kalonte në Mokër. Kjo rrugë u bë e mundur falë vendosmërisë së kryeministrit por edhe lobimit e përpjekjeve të shumë mokrarëve. Kur kjo rrugë dhe rrugët lidhëse të fshatrave me rrugën të kenë mbaruar, Mokra do të jetë krejt tjetër.."



Istref Haxhillari, çmimi i tretë në konkursin kombëtar të tregimit

Në mesin e 60 krijimeve krijimi "Thikat e Vardarit" iu botuar edhe në faqet e gazetës "Mokra", u vlerësua nga krijuesit dhe në fund autori fitoi çmimin e tretë.



"Taxh Mahalli", mrekullia e ndërtuar nga një shqiptar


## Atje ku rrokullisen butet e bëhet qejfi tamam!

Intervistë me aktorin e pijetarin e mirënjohur Vasillaq Vangjeli



Një festë e veçantë që s'e gjen në Ballkan

FAQE 4-5



## AMANETI

Sipas bisedave me mikun tim, të ndjerin Behar Shtylla nga TOMI MATO

### EKSPOZITA "DITË DIMRI 2010" NË POGRADEC

Në qytetin e Pogradecit përfundoi kolonia e lirë artistike "Ditë Dimri 2010" e cila u zhvillua në datat 15 - 22 Janar me pjesëmarrjen e artistëve të njohur shqiptarë Abdurrahim Buza, Sadik Kaceli, Kujtim Buza, Buron Kaceli, Agron Polovina, Albes Fusha, Anastas Kostandini...



Shoqata "Pelioni" feston 10 -vjetorin e krijimit dhe festën e Vitit të Ri 2010

### Magjia e këngës

Tregim nga Istref HAXHILLARI

**MOKRA TRIME**

POEZI NGA PËLLUMB XHELOLLARI



# Shoqata "Pelioni" feston 10 -vjetorin e krijimit dhe festën e Vitit të Ri 2010

Një takim krejt i veçantë, siç është bërë tashmë traditë prej mëse dhjetë vitesh, u zhvillua në prag të Vitit të Ri, mes anëtarëve të kryesisë së shoqatës "Pelioni". Ky takim me rastin e festave përkoi edhe me 10-vjetorin e krijimit të kësaj shoqate. Ambientet e restaurant "Gorës" ushtuan nga urimet, kënga dhe vallja mokrare. Të pranishëm, si mysafirë të nderuar, këtë vit ishin edhe n/kryetari i shoqatës, Istref Haxhillari dhe poetja elbasanase Lida Lazaj, anetare e klubit letrar "K. Kristoforidhi" në Elbasan, dasha-mirëse e Mokrës sonë, si dhe publicistit Spasse Thanasi, i pranishëm në gazetën tonë prej vitesh. Festa e përvitshme është njëherësh edhe një bilanc i punës së kësaj shoqate dhe i gazetës "Mokra", e cila ka vijuar daljen e saj rregullisht duke qenë një zë i veçantë dhe i domosdoshëm për të gjithë mokrarrët. Tashmë ajo është faktor dhe ka hyrë prej kohësh në shtëpitë dhe zemrat e sa e sa mokrarrëve, kudo ku ata ndodhen, madje edhe jashtë vendit.



Anëtarët e kryesisë së kësaj shoqate mbledhen dy herë në vit në festa të tilla,

një herë në përvjetorët e gazetës, që përkon në muajin mars, me daljen e numrit të parë dhe një herë në festën e bukur të Vitit të Ri, pa llogaritur aktivitetet dhe takimet e tjera gjatë vitit. Takimi, apo festa e Vitit të Ri, ishte një takim i ngrohtë, mbresëlënës, jashtë çdo pompoziteti e falsiteti. Në takim veç urimeve të ngrohta, shakave dhe trokitjeve të gotave, në "dollinë" mokrare, u lexuan poezi e krijime nga të pranishmit për Mokrën dhe mokrarrët. Veçanërisht u duartrokitën krijimet e Lida, Istref Haxhillarit, Spase Thanasit dhe Pëllumb Xhelollarit. Me urimin për një vit të mbarë, me suksese e botime të reja u mbyll nën tingujt e muzikës festa e përvitshme. Mirë u takofshim në Pogradec, në mars, me rastin e 11 -vjetorit të daljes së numrit të parë të gazetës "Mokra"!

## Istref Haxhillari, çmimi i tretë në konkursin kombëtar të tregimit

Shkrimtari i mirënjohur, autor i disa librave Istref Haxhillari është vlerësuar këto ditë me çmimin e tretë në konkursin këmbëzat të tregimit, i organizuar nga revista letrare "Obelsik". Në mesin e 60 krijimeve krijimi "Thikat e Vardarit" iu botuar edhe në faqet e gazetës "Mokra", u vlerësua nga krijuesit dhe në fund autori fitoi çmimin e tretë. Ky është një ndër konkurset e pakta që zhvillohen në vend dhe ky çmimi e parë për Istrefin është edhe një ogur i mirë për viti 2010. Gjithashtu në këtë konkurs u vlerësua edhe po këtë çmim edhe krijuesja tjetër pogradecare Meri Lalaj.



## EKSPOZITA "DITË DIMRI 2010" NË POGRADEC

Në qytetin e Pogradecit përfundoi kolonia e lirë artistike "Ditë Dimri 2010" e cila u zhvillua në datat 15 - 22 Janar me pjesëmarrjen e artistëve të njohur shqiptarë. "Ditë Dimri 2010" startoi me hapjen e ekspozitës në fushën e arteve figurative ku u paraqitën punë të piktorëve Abdurrahim Buza, Sadik Kaceli, Kujtim Buza, Buron Kaceli, Agron Polovina, Albes Fusha, Anastas Kostandini, Arben Golemi, Dhimitraq Kolevica, Gentian Zeka, Gjergji Lako, Hasan Nallbani, Kastriot Dervishi, Leon Çika, Lllazar Myzeqari, Mustafa Araqi, Nexhmedin Musaj, Roland Karanxha, Rruzhdin Goskova, Vangjo Vasili, Ziso Kamberi dhe Arif Lushi.



I gjithë aktiviteti ishte i ideuar nga fotografi Ardian Fezollari dhe piktori Vangjo Vasili në bashkëpunim me Galerinë e Arteve Figurative të qytetit të Pogradecit.

Ky edicion i parë i "Ditë Dimri 2010" prezantoi një aktivitet kulturor me një filozofi të qartë, i cili ka synimin që të kthehet në një aktivitet të përvitshëm dhe që synon të sjellë vlera artistike të reja në qytetin e Pogradecit. "Ditë Dimri" është konceptuar prej organizatorëve si një aktivitet i hapur, i lirë me një aktivitet qendror që përbën bërthamën e tij dhe që është ekspozita e ARTEVE FIGURATIVE, por që synon të jetë njëllor i hapur edhe për njerëz të fushave të tjera të arteve, të letërsisë, poezisë, fotografisë, arkitekturës por edhe ndaj koleksionistëve dhe dashamirësve të artit, pa përjashtuar aspak këtu dashamirësit e vetë qytetit të Pogradecit. Ajo lindi më tepër si një dëshirë e brendshme e artistëve vendas dhe ky dimension do ta mbajë gjallë atë.

Një nga synimet e "Ditëve të Dimrit" është të promovojë edhe qytetin e Pogradecit si një qytet që ka pjesën e vet tërheqëse dhe të bukur jo vetëm në verë por edhe në stinën e dimrit të cilën e reflekton që nga ngjyrat e pafundme të liqenit, deri në ditët kur është një qytet kur është gati-gati monokromatik nën tisin e dëborës.

Një nga organizatorët e ekspozitës, piktori Vangjo Vasili shpreh: "Ditët e dimrit janë ato që na izolojnë ne na njëri-tjetri, por janë edhe ato që na bashkojnë mendërisht dhe që bëhen kristalizuese për formimin artistik. Në ditët e dimrit zë fill rrëfenja

e shtruar e Mitrush Kutelit. Në ditët e dimrit kur e ftohta e natyrës dominon botën fizike lind si nevojë për krijimin e ngrohta si nevojë shpirtërore e mbiekzistencës njerëzore. Kjo stinë ka qenë e lidhur ngushtë me krijimtarinë artistike të shekujve."

Ndërsa gjatë ceremonisë së hapjes Neli Naço u shpreh: "Ekspozita "Ditë Dimri" është një ekspozitë e hapur dhe që kërkon të sigurojë vazhdimësi, ajo ka sjellë emra të njohur të piktorëve shqiptarë në Pogradec, që mund të sjellë njëkohësisht edhe traditën edhe të rene e arteve shqiptare në qytetin e Pogradecit. Përfitimet më të mëdha në arte kanë lindur duke u nisur nga liria si një koncept i rëndësishëm që shoqëron që nga fillimi procesin e krijimit artistik. I gjithë aktiviteti i "Ditëve të Dimrit" starton si një proces i hapur dhe shumëplanësh, që synon të pasurohet me vlera të reja dhe të ketë shumësinë kuptimore të tij. Vlera e aktivitetit vjen prej gjithsecilit që është pjesëmarrës pa harruar kushtin e profesionalitetit që e shoqëron këtë aktivitet."

Pjesa më e rëndësishme e aktivitetit, ekspozita e pikturës u vlerësua veçanërisht nga kritiku i mirënjohur i artit Pino Bonnano.

Ekspozita shoqërohej edhe me katalogun e punimeve të artistëve, katalog i cili u dizajnuar dhe financua nga fotografi i mirënjohur Ardian Fezollari.

"Ditë Dimri 2010" synon të jetë një aktivitet jetëgjatë dhe të ketë impaktin e vet në kulturën shqiptare.

## FINACOHET PROJEKTI I II-TË PËR POGRADECIN

Më datën 28 dhjetor 2009 projekti u nënshkrua marrëveshja lidhur me projektin e mbrojtjes së liqenit të Ohrit, pastrimi i ujrave të zeza-Pogradeci-II Ohrit, të financuara nga banka Gjermane për zhvillim. Dy ministrinë, ajo e financave dhe ajo e Punëve Publike pritën ambasadorin e Gjermanisë Berna Borchard, ceremoni gjatë së cilës u nënshkrua edhe marrëveshja. Fondi total i përdorur deri tani në fazën e parë nga ana e gjermanëve kap shifrën 5 milionë, ndërkohë që me 800 mijë eurot që u shitën së fundmi ai shkon në 5.8 milion euro. Qveria gjermane deri tani ka investuar dhe ka angazhuar një shumë



totale prej 850 milion euro për projektin investimesh në të gjithë Shqipërinë nga të cilat më shumë se 50% implementohet nga banka Gjermane për zhvillim.

## K R R T-ja MIRATON PLANIN RREGULLUES TË QYTETIT TË POGRADECIT

Bashkia e Pogradecit miratoi planin rregullues të qytetit më datën 22 dhjetor 2009. Kjo do të sjellë disiplinimin e ndërtimeve në qytet, por edhe zbatimin me efikasitet të investimeve në infrastrukturë. Një nga qytetet më të prekura në ndërtimet pa kriter, ku nuk është harmonizuar në 20 vitet e fundit tradita me modernen, Pogradeci ka nevojë për një harmoni urbanistike."Në rast se një plan rregullues do të ishte zbatuar 20 vite më parë, do të kishte një disiplinim më të madh mes ndërtimeve të vjetra dhe të reja. Gjithashtu do të kishte një harmonizim mes objekteve ekzistuese që i përkasin zonës historike dhe pjesës zgjerimitme hapsirat e reja, ku aktual-

isht dominojnë ndërtesat e larta dhe me karakter modern", u shpreh kreu i bashkisë Artan Shkëmbi. Plani rregullues parashikon sistemimin e rrugëve, krijimin e shetitoreve, bulevardet, segmente me korsi të veçanta për mjete dhe biçikletat, përmisimin e kanalizimeve dhe sidomos ruajtjen e zonës muzeale. Sipas Shkëmbit, me planin e ri rregullues të miratuar nga KRRT do ti jepet zgjidhje një sërë problemesh, si dhe zhvillimit arkitektural dhe urban të qytetit. Qyetei i Pogradecit ka një shtim të ndjeshëm të popullsisë dhe rezultoni që gjatë 20 viteve të fundit ndërtime të shumta kanë cenuar anën karakteristike të tij.



Intervistë me deputetin e Pogradecit, z. Fatbardh Kadilli

# Mokrarëve u kam borxh besimin, besën

**Z**. Fatbardh, në radhë të parë ju urojmë detyrën fisnike si përfaqësues i popullit të Pogradecit dhe Mokrës në Kuvend. Pas mëse 6 muajsh, dëshirojmë të dimë se si ndiheni sot, si deputet i PD për ogradecin dhe Mokrën?

- Së pari, më lejoni edhe mua të shpreh falenderimin tim për ju si gazetë që jeni një përcjellës i shkëlqyer i zërit të Mokrës. Kariera ime në politikë filon më herët se zgjedhjet e vitit 2009, por nga momenti i zgjedhjeve kariera ime ka ndryshuar krejtësisht. Ndryshe nga funksionet e mëparshme, këshilltar i Kryeministrit apo të tjera, sot unë nuk përfaqësoj vetëm vetveten dhe forcën politike, Partia Demokratike, sot në Kuvend, si deputet unë ndjej përgjegjësinë e madhe si përfaqësues i të gjithë banorëve të krahinës. Ndjej përgjegjësinë para atyre që më votuan, por edhe para atyre që nuk më votuan. Ndjej përgjegjësinë para çdo individi, familje apo i moshuar. Ky është një ndryshim i madh dhe unë jam i ndërgjegjshëm për këtë, jam i ndërgjegjshëm për atë që unë duhet të jap para krahinës, para çdo banori.

- Ç'do të thotë për ju të jesh deputet i popullit mokrar, pra të përfaqësoh atë popull në Parlamentin shqiptar?

- Përfaqësimi është një përgjegjësi e madhe. Por, përfaqësimi është në radhë të parë besim. Që në momentin që kam dalë para njerëzve dhe u kam kërkuar të më besojnë unë e di që u kam atyre një borxh. Dhe ky është borxhi i besimit, i besës. Dhe unë e di që kjo për mokrarët është veçanërisht e shenjtë. Në kuvend unë përfaqësoj besën e mokrarëve. Në kuvend, si përfaqësues unë do të vë gjithë fuqinë e mijë që të përcjell zërin e popullit mokrar. Mokra është përfaqësuar në Kuvend, por edhe në kuvende të Shqipërisë nga njerëz të nderuar. Jam i bindur që të gjithë ata që kanë përfaqësuar Mokrën kudo, kanë ndjerë të njëjtën krenari që ndjej edhe unë sot si përfaqësues i një krahine dhe një populli që nderohet kudo në Shqipëri.

- Cilat janë lidhjet dhe njohjet tuaja me Pogradecin dhe Mokrën?

- Unë kam lindur në Tiranë, por Pogradeci është origjina ime. Unë jam me origjinë nga Starova, aty ka lindur dhe është rritur babai im. Familja e babait tim ka lëvizur në vitet 50. Gjyshja ime është nga Velçani. Kështu që origjina ime është e lidhur ngushtë me gjithë rrethin e Pogradecit. Dhe origjina reflektohet në çdo gjë. Që tek e folura në shtëpi, tek gatimet, tek miqtë e musafirët, e deri tek krushqitë, kudo ishte Mokra e Pogradeci.

- Cilat janë marrëdhënjet tuaja me



pushtetin vendor, bashki e komuna?

- Unë kam marrëdhënje shumë të mira me të zgjedhurit vendor dhe u kam shtrirë dorën e bashkëpunimit pavarësisht se cilës force politike i përkasim. Për mua të gjithë të zgjedhurit i përkasim popullit dhe duhet të bashkëpunojmë për të bërë më të mirën. Kam bashkëpunuar me të zgjedhurit vendor për të mbështetur projektet për komunitetet.

- Cili do jetë ndikimi juaj për zhvillimin ekonomik e infrastrukturor të zonës së Mokrës, duke u nisur edhe nga përvoja juaj pranë Kryeministrit?

- Unë i përkas një maxhorance politike që ka shpallur si objektiv të vetin madhor ndërtimin e Shqipërisë Europiane. Unë e kam shprehur më se një herë që nuk mund të hyjmë në Europë pa bërë më parë që jeta e çdo shqiptari të jetë si e një europiani. Ne duhet t'i bëjmë shkollat, spitalet, rrugët, ujsjellsat si në Europë, pastaj të jemi pjesë e saj. Sa i përket Mokrës projekti më i rëndësishëm dhe që do t'ia ndryshojë faqen Mokrës është ai i ndërtimit të rrugës Qukës-Pllaçë. Ky është investimi publik më i madh në historinë e Mokrës, ndoshta që nga koha e romakëve që ndërtuan Via-Egnatia, një segment i të cilës thuhet se kalonte në Mokër. Kjo rrugë nuk qenë premtim elektoral, sic edhe pretenduan kundërshtarët tanë politik, ajo është një realitet që po zhvillohet dita ditës. Ndërtimi i rrugës do të jetë përcaktues për zhvillimin ekonomik. Rruga do të shkurtoj kohën që mokrari të dalë në Korçë apo Tiranë, që produktet

*"...Sa i përket Mokrës projekti më i rëndësishëm dhe që do t'ia ndryshojë faqen Mokrës është ai i ndërtimit të rrugës Qukës-Pllaçë. Ky është investimi publik më i madh në historinë e Mokrës, ndoshta që nga koha e romakëve që ndërtuan Via-Egnatia, një segment i të cilës thuhet se kalonte në Mokër. Kjo rrugë u bë e mundur falë vendosmërisë së kryeministrit por edhe lobimit e përpjekjeve të shumë mokrarëve. Kur kjo rrugë dhe rrugët lidhëse të fshatrave me rrugën të kenë mbaruar, Mokra do të jetë krejt tjetër.."*



e krahinës të arrijnë tregun në 20-30 minuta, që shërbimet, mjeku apo mësuesi të vijnë me shpejtë e më lehtë, që të rinjtë të arrijnë më lehtë e më shpejtë shkollat. Kjo rrugë u bë e mundur falë vendosmërisë së kryeministrit por edhe lobimit e përpjekjeve të shumë mokrarëve. Kur kjo rrugë dhe rrugët lidhëse të fshatrave me rrugën të kenë mbaruar, Mokra do të jetë krejt tjetër. Përveç investimit të rrugës, qeveria do të rrisë buxhetin për subvencionimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

- Për lexuesin e gazetës "Mokra" diçka më shumë për jetën tuaj si intelektual dhe si deputet?

- Angazhimi im kryesor është parlamenti, por nuk la pas dore dhe angazhime të tjera në jetën publike. Ndonëse nuk jam gazetar, unë shkruaj rregullisht në shtyp. Kjo është një mundësi

si për të shprehur edhe ato shqetësime që nuk janë në vëmendjen kryesore të politikës, por që kanë vëmendjen e shoqërisë. Përveç botimit të artikujve në rubrikën e përjavshme që mbaj në një të përditshme (Standard), jam në kontakte me organizata jo qeveritare për të organizuar aktivitete të natyrës kulturore kryesisht në Pogradec me dëshirën për të pasuruar jetën tonë shpirtërore. Jan disa projekte për ekspozita pikturore, shfaqje teatrore etj. Një synim imi është forcimi i lidhjeve me mokrarë të tjerë të suksesshëm që janë në Tiranë apo në qytete të tjera për të bashkëpunuar në mirë të krahinës. Ka mjaft djem e vajza të reja që ia kanë dalë të jenë sot gazetarë, apo profesionistë të nderuar të cilët po të bashkohen kanë se çfarë i japin krahinës.

Intervistoi;  
**Pellumb ZADE**

## Shpirti mokrar

**I**shtryrë nga dëshira e madhe, e ndjej detyrë të shkruaj për cilësitë e shpirtit Mokrar. Më ra fati të punoja specialist në Gjendjen Civile prej vitit 1947 deri në vitin 1983, plot 46 vjet, kur dola në pension, detyrë të cilën e kreu me ndershmëri. Natyra e punës kishte të bënte me popullin, t'i shërbeja, duke i vlerësuar sikur t'i kisha vëllezër e motra.

Duke shkruar në çdo fshat u shpegonja Kodin Familjar, që aq shumë ishte i nevojshëm. Pushteti Lokal më dërgonte në fshatra edhe në fshata ekonomike, krahas saj bënja edhe punë bindëse nëpërmjet shtypit. Nuk kam lënë familje e fise pa i njohur ashtu si të gjithë kuadrat e tjerë. Populli i priste dhe i vlerësonte ata.

Po çfarë karakteri ka mokrari? Një popull bujar dhe mikpritës, një popull me dashuri dhe dhembshuri, bujar, humanitar. Në ato vite Mokra ishte analfabete, por zemërgjerë nga të gjitha. Të rrije me mokrarët, të punoja dhe të bisedoja me ta, unë e quaj shkollë të madhe. Të gjitha familjet të prisnin me kënaqësi, të cilën do ta vlerësoja kështu: haja bukë me mjalte, se mjalte është fjala e tyre. Me ta bisedoja çdo problem, të cilët i dëgjoja me vëmendje dhe i vlerësoja seriozisht. Një nga ato ngjarje: kish ndodhur një grindje në Çervenakë në një familje nga një zjarr. Të afërmit ishin interesuar të zgjidhej. Fajtori ishte gjendur. Por ishte e pamundur. Këtë mund ta zgjidhte vetëm

Petroja, që ishte në Podkozhan, që kishte ardhur nga Çervenaka. Ishte një plak me shumë pjekuri, të cilit i kërkoi ndihmë Çaushti i Çervenakës. Petroja nuk nguroi, por pasi e priti si mik e si vëlla, e dëgjo dhe të dy u nisën drejt fshatit. Fjala e Petros, mendimet e tija bënë që grindja të sqarohet e të mbyllet me mirëkuptim e me dorë në qafë. Gjithë farefisi pleqtë e nderuar e të mençur fshati i nderoi sipas zakonit.

Ndërkokësor është i vlerësuar dhurimi i fëmijëve njerëzve të afër dhe ky nuk është një rast: të tillë ka në Kalivaç, Podkozhan, Pleshisht, Dunicë, Jollë e të tjerë. Kjo ka sjellë edhe një dashuri dhe mirëkuptim edhe më të madh midis tyre, por edhe më gjerë. Një rast: Gjok Tola me Ligorien i falin djalin Risto Pjetrit nga Pleshishti, duke e uruar: ta mbush të derën plot! Dhe për çudi ai me familjen e tij lindën 10 fëmijë. Vetëm nga ky djalë u bë 10 herë krushk, 20 herë nga fëmijët e

tjerë, gjithësej 36 herë. Mokrarët me zemër të madhe e të gjerë dinë të falin edhe gjakun, me arësyen e fortë e të kthjellët dhe raste të tilla ka në Mokër. Mokrari nuk e ka patur në traditë të përvetësoi pasurinë e të tjerëve, nuk ka qënë vjedhja cilësi e tij. Shpirti mokrar është i pasur edhe me shprehje urimi, kur përshëndetin: Zoti të nderoftë e të gëzoftë! Ta shtoftë e të tjera. Sofra mokrare është një pasuri tjetër me vlera, punëtorë, të këngës e të muhabetit. Nuk është rastësi që shumë çupa mokrare janë nuse në qytet. Mokra i ka dhënë kombit tre dëshmorë të gjuhës shqipe: Gjok Shqiptarin, Aleks Andrea (Hoshtëça), Apostol Kollçakun. Mirëkuptimi, toleranca, bashkëjetesa fetare është një tjetër vlerë e Mokrës dhe e mokrarëve kudoqë ndodhen. Këtë e tregojnë miqësitë, krushqitë, vizitat dhe gjithëçka flet në të mirë të këtij komuniteti e pse jo edhe të këtij Kombi.

Vangjel BURNAZI



Tradita: Mbështetje për zhvillimin e turizmit vëndor!

# Atje ku rrokullisen butet e bëhet qejfi tamam!

Nga Koço PIHONI

**P**rej vitesh është bërë traditë, promovimi i një feste të re qytetare, besoj më e bukura në vend e më gjera në gjithë Ballkanin, si origjina e hardhisë e prodhimit prej saj të pijes së verës e rakisë. Si fillim, pak histori nga mitologjia e antikiteti grek e ilir që, besoj, do të shërbejë si argument për këtë shkrim. Është fakt historik se mbretit Bardhyl të Enkelejve i kërkuan dorën e vajzës së tij të quajtur, Lydiana, për princin Tindaurin, djalin e një mbreti helen, një miqësi që ai e pranoi. Nga lidhja e tyre në kurorë, ata suallën në jetë katër fëmijë, dy djem Kastorin "Kostandinin" dhe Polidefin dhe dy vajza Klimnestrën dhe Helenën e bukur, të cilat u bënë më pas pjesë e trashëgimisë të antikitetit. Tregohet se mbreti Bardhyl i Enkelejve i dha në prikë vajzës së tij edhe një sasi kalemash hardhi rrushi, të cilat në kushtet e atij vendi me klimë mesdhetare, atje ku u mbollën e shumuan në qindra hektarë vreshtari, dhuratë e çmuar e shumë bujare e bërë nga mbreti Ilir miqve, grekëve të vjetër. Edhe diçka, atje ku ku prehet në përjetësi, Helena e bukur e Trojës, është një pyll i bukur, një vend burimi ujqor, një sargofag i gurtë, sikurse janë varrezat ilire të Pelionit në Selcën e Poshtme, jo shumë hostenë larg saj. Në hyrje të varrezës, atje ku rrjedh pandërprerë një ujëvarë, që ka mbi krye kurorën më të madhe dy ngjyrëshme, të blertë e të bardhë, nga më të bukurat në botë, atje në pyjet e Lenijes në Valamarë të Pogradecit të sotëm, atje ku ndodhet ky varr i fshehur, shumë herë më i çmuar se dhjetëra piramida të marra së bashku, mbasi atje prehet në përjetësi një nga personalitetet që bart historinë e antikiteti iliro – helen!

Duket sikur dhe Zoti vetë, verërat dhe vajzat e bukura i dashuron në përjetësi! Një zbulim ky, që do t'i shërbejë shumë turizmit elitar shqiptar që, besoj, do të vlejë më shumë se qypa të tërë me flori.

\*\*\*

Për të ardhur e për të folur më pas me respekt e mirënjohje për traditën pogradecare, të vreshtarëve, vertarëve e derrarritësve e peshkatarëve, pasrëtmabërsit e tregtuesve. Tradita është aty. Prej qindra vitesh është kultivuar hardhia, deri në vitin 1967, të gjitha familjet pogradecare kishin vreshta i punonin e prodhonin rrush, të gjithë kishin bute, ku shtinin rrush e prodhonin në mënyrë artizanale verë e të gjithë ishim e janë përdorues të verës e rakisë, sa sot është aksiomë gjithandëj thonë se pogradecarët nga të qenët pijetarë janë të dalueshëm nga të gjithë të tjerët!

Me nderim e respekt duhen kujtuar disa prej vreshtarëve e verëtarëve pogradecarë, pionierë të traditës prodhues e tregtues të mesëm, dje e sot. Kujtoj Vasil Cokun, Fani Naçon, Tushi Llakmanin, Zisi i Kuzit, Vasil Shukja, Spiro e Jovani i Bendos, Ademi i Lakes, Haki Haxhillari, Asim i Velës etj, sot Rako Çomo, Tomi Naço, Rako Krëste, Artur Blacëri, Genci Shyta etj.


Dhe deri në vitin 1990 Pogradeci kish kantinën e fabrikën e verës e pijeve, ku përpunoheshin më mijëra tonelata rrush, i prodhuar kryesisht nga ndërmarrjet e kooperativat ujqësore të rrethit, ku vera "Pamid", "Pogradeci", "Gemsji", raki "Perlë" e "Muskat" ishin me famë.

Koha sot kërkon që të shtohet prodhimi i rrushit sipas kultivarëve të duhur, të përshatet teknologjia e përpunimit të rrushit e marketimi dhe etiketimi i saj, që t'i përgjigjet kërkesave e standardeve që kërkon ky tregu sot për turizmi tonë vëndor. Festa pogradecare tashmë ka fituar qytetarinë dhe është bërë pjesë e programuar e punës së Bashkisë, si një promovim afatgjatë i punës së saj deri në realizimin e objektivit. Qyteti ynë duhet të ketë përparësi në zhvillimin e turizmi gjithëvjetor. Festa është konceptuar si një koncert me dy pjesë, i realizuar në dy mbrëmje radhazi. Për këtë koncert është punuar për shumë ditë me një plan masash teknike organizativ shumëplanësh, në grupe pune e persona përgjegjës. Edhe për dekorin e ndriçuar të gjithë qytetit e veçmas për atë në shëtitoren "Fan Noli", të ndodhur ne Bulevard Evropa "nesër", ku u zhvillua një panair i vërtetë me pjesëmarrje të gjerë, sidomos në natën e parë.

Gjatë këtyre netëve u festua masivisht në shesh, lokale e në familjet qytetare. Nata e parë kishte për kryefjalë një program artistik me konkurrime, poezi për verën dhe mbyllej me shpalljen e fituesve. Ky aktivitet drejtohej nga poeti pogradecar Dhimitër Pojanaku.

Çmimin e parë e fitoi poezia e Marjana Shkurtit, por fituesi më simpatik i mirëpritur u shpall poet e pijetar njëherazi, z. Kiço Jovan Gusho, i njohur si Kiço "Balashi", kjo për arsye të njohjes së tij si shofer që shpërndante mobilje në të gjithë Shqipërinë. Kjo natë ngjasi me një dasmë të madhe, ku "përjashtoj" nusen e dhëndrin që diheshin, "dasmorët" ishin të shumtë mbi çdo përlogaritje e ftesa të dërguara dhe ndodhi tamam sipas traditës, ku thuhet se në dasëm e mort shkohet e pa ftuar! Po, me të drejtë, thuhet se çdo problem ka zgjidhje. Brenda fare pak kohe arritën tavolina e karrige nga "vëllazëria", në këtë rast nga turizmi "Enkelana e Bar – Llakmanët", gjë që e bëri këtë mbrëmje festive me më shumë

Natë e Dytë, në ambientet e bar – restorant "Tea"/Nata e shpalljes së fituesve



se kurrë të kishte pjesëmarrje qytetare. Festa ishte shumë mbresëlënëse, shumë e ngrohtë, vërtet argëtuese, një mrekulli më vete.

Në këtë natë festive kish dhe ftuar nderi personalitete të vëndit e të huaj. Në mbyllje të kësaj nate te parë të festës, kryetar i Bashkisë, z. Artan Shkëmbi, përshëndeti gjithë të pranishmit, ndër ta dhe mikun grek, kryetarin e Bashkisë së Voliosit, i cili shoqërohej nga një grup biznesmenësh të interesuar për zhvillimin e binjakëzimit me qytetin tonë. Nga fjala përmblylëse e tij do veçoja disa thënie të drejtuara, kryetarit të "emëruar" për ta drejtuar këtë natë gala, z. Dhimitër Pojanakut, të cilin e falënderoi dhe e përshëndeti për këtë angazhim të tij. Më pas nuk harroi që, më humor, t'i drejtohej Pojanakut për ta falënderuar për vlerësimin që treguan në realizimin e kënaqësinë që përcolli

atmosfera e kësaj nate. "I dashur Pojanak, besoj se duhet të jeni të kënaqur se ju poetët shkruani, ndërsa ne, Bashkia, paguajmë. Juve merrni çmime, bëheni të famshëm, ne prapë paguajmë. Ju hani, pini e këndonin, shpenzimet Bashkisë ia faturoini!", tha me humor Shkëmbi. Në këto çaste unë kujtova një klerik të vjetër e pijetar, zoti e ndjeftë priftin Papa Ndonë, ai iu thoshte bashkëqytetarëve: "Hani, pini e këndonin, se mëkatet u fal, sa të jem unë gjallë Papa Ndoni!", rëndësi ka që edhe juve ta dini e të na mirëkuptoni. Duke u përshëndetur më të gjithë pjesëmarrësit u mbyll me duartrokite kjo nata e parë që shkoj si jo më mirë.

Pas kësaj nate poetike, ku fjalët e vargjet u pëlqyen" e nga poeti i madhi Lasgush, i ndodhur në parkun aty pranë, jo më larg se 30 m kësaj bar anije që vozit në liqen.



Intervistë ekspluzive me aktorin e madh të skenës z Vasillaq Vangjelo e mikun Grek të pranishëm Stergios Papajohano, presidenti i "Pelion Development Institut"

**D**ita e dytë e festës filloi paraditen e saj, me degustimin e verërave të sjella për konkurrim dhe vlerësimin për verërat fituese, si dhe vlerësimin e shoqërueses së verës fituese. Mezeja me shenjë e kjo do shpallet në mënyrë publike në mbrëmjen përmblylëse, tek lokali i përzgjedhur për festimin tek bar-restorant "TEA", në shëtitore F. Noli të bulevardit "Europa". Qytetarët duhet thënë ishin të shumtë e festonin në lokalet përreth, për shkak të një moti të keq që duhej përballuar e mundur, domosdo nga ne e ajo e bekuara, verëa fituese, që derdhej nga kanellat e buteve si rrëke e lumë. Dhe, kur në bar – restorant valonte pija e kënga e shoqëruar nga trupa e grupit të ansambli të këngës pogradecare "Nostalgjia", nën drejtimin e maestër J. Shuke, i mirënjohur nga qytetarët e më gjërë si "Xhuvit i Zagorkës" në respekt dhe të nënës së tij të ndjerë, aktore të shumë roleve ne trupën e Estradës, Teatrit të qytetit, ku unë po veçoj rolin në filmi i Kinostudios "Shqipëria e Re", "Kapedani". Ndërkohë në tavolinën kryesore kishin zënë vend titullari i Bashkisë, me stafin, njëherazi ai do ishte dhe shpallësi e dhënësi i çmimeve fituesave apo i certifikatave të ndryshme. Z. Artur Blacëri shpallet fitues i vitit 2009, tashmë prej 8 vjet e z. M. Abrashi në prani e të miqve të nderuar që e shoqëronin dhe "festonin bashkë me ne", në tryezë tashmë ku ndodheshin përkrah verërave fituese e zoti Kulaci i Mokrës e "Bostantava e Nolit", emër ky i marrë për nder të Nolit 85 vjet më parë, sot në vlerësim të tij sheshi mban emrin e këtij personaliteti. Ambienti i kësaj nate u elektrizua kur të pranishmit, enkas kish marrë udhën e gjatë për të qenë i pranishëm, aktori i nderuar i skenës shqiptare, Vasillaq



Intervistë me aktorin e pijetarin e mirënjohur Vasillaq Vangjeli dhe miqtë grekë

# Një festë e veçantë që s'ë gjen në Ballkan

← Vangjeli,

nostalgjiku shoku e miku i Pogradecit e shumë poradecarëve, po veçmas i shkrimtarit publicistit birit e "Qyterarit të Nderit" të qytetit tonë të paharruarit Niko Nikollës që Vasolja në të gjallë e nderonte e i drejtohej me fjalën Usta!

Vasua debutoi në mënyrë mjeshtërore me disa "parodi", serenata korçare, të sjella në këtë kohë "moderne" që jetojmë. Do dëshiroj të them se lezetin kësaj feste ia shtuan e "lapsuset" në prezantimin nga koferencieria, për ju z Vasillaq "Gjoka" që më pas për korrigjim e prezantoi si "Koçin e Sofkës të teta Ollgës" i menjëhershëm qe reagimi i aktorit: Po tha ai me humor, Juve kush jeni, Violeta Manushi?! Kaq mjaftoj që asaj ti ikë "figura e zëri" e pjesëmarrësit të qeshnin me lot!

Dhe më pas, pas një pauze, debutoi përsëri z Vangjeli një parodi më motive greke për nder të një grupi prej dymbëdhjetë biznesmenësh grekë, të ftuar e të pranishëm në këtë festim. Ky debutim ishte i pa parashikueshëm nga miqtë grekë dhe nuk gjenin fjalë për të shprehur falënderimin, mirënjohjen për këtë ngrohësi të krijuar të paimagjinuar se mund të gjenin tek populli vëllash shqiptar, për të cilën në intervistë miqësore të marrë prej presidentit të këtij Instituti u kërkua që t'ju plotësohej në kërkesë e dëshirë që në një të ardhme të afërt, grupi i këngës "nostalgjia" e aktori i skenës z Vasillaq Vangjeli të pranojnë ftesën për të bërë një vizite në vendin e tyre, ftesë që u pranua me kënaqësi nga të ftuarit e z V.Vangjeli. Festën në shoqërinë e z Vasillaq e Artur Blacërit "Fituesi kampion" e disa shokëve e miq të tjerë, ndër ta dhe pronarit të lokalit Ilirit të Rushkës, Bashkë festuam deri në orë të vona të mbas mes natës. Me z Vasillaq Vangjelin u ndamë duke i uruar një natë të mirë, për t'u takuar në mëngjesin e



asaj dite në bar-hotel-turizmi "Enkelana" për të pirë kafënë e mëngjesit e për t'i marrë këtë intervistë në prag dhe të Krish-tlindjeve e Vitit të ri.

Pasi u takuam e pasi mësova se kish bërë një gjumë të mirë, ftuam kamerierë të mer-te porosinë, i cili nuk vonoi të mbrinte e të na përshëndesë, si shpërblim nga Vasillaq Vangjeli, mori një përshëndetje e më pas ftesën për t'u ulur në tavolinë e të shfaqte vetëm dëshirën, ç'dëshironte të pinte nga ne?! Kamerieri u befusua nga kjo sjellje e paparë dhe më buzë-qeshje u përgjigj se është kënaqësi për mua t'ju shërbej "Çfarë dëshironi?" Vasillaqi kërkoi t'i shërbehej një Salep e unë një çaj. Në bisedë më tha se ky filxhan salep ka brenda shumë nostalgji, më çon shumë vite para në 68-69 kur unë kam kryer shërbimin ushtarak këtu në Malin e Thatë, ku ne e mblidh-nim gjatë verës vetë salepin atje dhe e përdornim më tej.

Më pas më duhej mua që ta falënderoja për mirëseardhjen dhe për atë atmosferë që krijuat me fjalët që thatë e debutimet me nivel të lartë që përçollët si dhe për ilaritetin e pa përshkruar që i bëtë dhuratë atij ambienti festiv me shumë të ftuar?

- Unë nga ana ime, gjej rastin të falënderoj grupin organizator për ftesën, të cilës ju përgjigja më kënaqësi dhe në nderim e respekt që kam unë për

Pogradecin e poradecarët ku veçoj dhe kujtimet e mija për Lasgushin, Niko Nikollën dhe shumë shokë Xhuvin, Roza Dhamin, Thanas Kostën, Kiço Beckën, Bardhi Hykën, Artur Blacërin dikur kamarier e hotel-xhi në atë Turizmin e vjetër të famëshëm, pa dyshim edhe juve.

Për të gjitha të tjerat që numruat ju ato ishin thjesht fjalë zemre dhe falënderimin për dekorin e ndriçimin janë të sin-qerta, ato nuk gjenden e as realizohen në Tiranë.

Në këtë natë festive ju tërhoqët vëmendjen e të pranishmëve dhe për takimin shumë miqësor që ju rezervoje Kryetari i Bashkisë, çfarë bisedoi me ju?

- Të falenderoj për këtë pyetje. Unë me zotin Shkëmbi nuk kam patur rastin të njihem më parë, po rasti është mbret. Për sa bisedova, mësova se babai im dhe babai i tij kanë qenë ushtarakë, shumë shokë, dhe se shumë vite përpara kemi qenë me shtëpi në një pallat në Tiranë, kur Tani atëherë ka qenë i vogël.

- Po tjetër?

- Më falenderoi për këtë ardhje dhe më befasoi e mrekulloi, kur më foli për motivin dhe vizionin që kish ai, edhe për festimin e kësaj feste, që për mendimin tim ai e konceptonte këtë si pjesën e dukshme të një strategjie vizionare për zhvillimin e këtij qyteti dhe rrethinave të tija me objektiv vitin e realizimit 2020, si infrastrukturë strategjike, që ka për themel punën këtu me vresh-tarët, përpunimin e rrushit, shtimin e prodhimit blektoral e peshkut, që besoj se këtë kërkon Evropa nga ne! Edhe unë e falënderova me gjithë zëmër, duke e uruar që dhe Zoti ju dhëntë shëndet për ta bërë këtë dëshirë një realitet të prekshëm dhe unë e besoj atë.

- Cfarë mendoni për këtë ditë festive ju si artist, z Vasillaq Vangjeli, por edhe si pijedashës?

- Është e vërtetë se verërat më të mira prodhohen në Bordo të Francës, po kjo festa e pijes së verës, kështu si u bëka në Pogradec "rëk" se gjendet vënd tjetër në Ballkan e nuk është çudi që kjo festë të bëhet e tillë jo shumë larg.

- E një pyetje të fundit, si ja kalon me punë Vasillaq Vangjeli, Koço Devole, kohën e planetit në fushën e artit skenik të vërtetë

të Humort Shqiptar aq të domosdoshëm?

- Më ke drejtuar një pyetur, atje ku më dhëmb më shumë.

Kam më se 4 vjet tashmë i flakur në rrugë të madhe pa punë burrë e grua, pa rrogë, pa pension, pa asnjë të ardhur me të dy fëmijët nëpër shkolla, çfarë të të them, më keq nuk bëhet. Unë as hasmit nuk do t'ia dëshiroj, për zgjidhje u detyruam të kthejmë shtëpinë në lokal e punoj më gruan, për të jetuar apo mbijetuar. Falënderoj shoqërinë që vinë pinë një kafe a një gotë dhe kur e do puna unë orkestror me atë instrumentin tim "Dy të bardha, një të zeskë". Koçua ja kalon edhe më keq se shiti shtëpinë vite më parë dhe jeton me qera në një garsoniere, fëmijët i ka në emigracion, besoj se është në hall të madh.

Besoj se kjo që po rrëfeni është tronditëse për çdo shqiptar që e mëson këtë të vërtetë, që pa dyshim flet shumë e tregon fytyrën e vërtetë të këtij shteti partiak, ku nuk vlerësohen ata që ligjërojnë, fisnikërojnë emancipojnë tërë shoqërinë...

- Sot kërkohen e vlerësohen ata që duhet t'i ngjasojnë një "qeni" besnik që mjafton vetëm "të lehtë, të lehtë, vetëm të lehtë" Si ta kuptojmë këtë disidencë, përzgjedhje? Çuditërisht që nga vet Jezu Krishti, biri i Perëndisë, Jeronin de Rada, Lasgushi e shumë artistë të tjerë duhet të vuanin, çfarë mëkate duhet të lajnë se kuptoj, përse?

- I dashur Vaso nuk më ngelet veçse t'ju falënderoj për këtë rezymë që bëtë dhe nga unë të pranoni një shkrim Monografi "maket" për Niko Nikollën që titullohet:

"Ky Engjëll a Shenjt midis Tre Jetëve" Si dhe fjalët e thëna nga "Kulaci i Mokrës"

Në mbyllje të këtij festimi bashkë me z Artur Blacërin, fituesin e Çmimit të Parë shkua për të shijuar Shishen me verën fituese në një mëngjezore, ku përgatitej paçe koke, atje te paçeria e preferuar me usta z Fani Shtyten që ndodhet kë krye të qafës së pazarit në rrugës "Naim Frashëri", bar-restorant "Roma".

Ku duke uruar njëri tjetrit që në ecje e sipër t'i lemë pas prapësinat e ishalla u bëftë mirë e më mirë për tërë shqiptarët kudo që jetojnë, punë e shëndet paçin! Dhe le t'i lutemi Zotit që "Fatit" jonë për vitin 2010 mos u bëftë pijetar e të pijë vetë e bie diku e s'ka kush ta ngrejë! Por të bëhet i fortë e të punojmë e disa vjet, sa t'i mbyllim edhe ca punë me nder me lezet e me faqe të bardhë.

Në përciellje ju dhuruan aktorin nga fituesi disa shishe nga kjo vera e kuqe fituese, për të festuar me familjen a shokët e miqtë e tij, atje në Tiranë në këto ditë të fund vitit!



## FESTA E VERËS NË POGRADEC

Temperaturat e ulta dhe dëbora nuk kanë penguar mijëra qytetarë pogradecarë të gëdh-heshin jashtë për dy net rresht në festën e verës, më 19 dhjetor 2009, një festë tashmë tradicionale e oragnizuar çdo fund viti nga Bashkia e qytetit. Dukej sikur vetë Dionisi kishte zbritur në brigjet e Ohrit.

Mes zjarreve në qendër të bulevardit "Evropa", çdo pogradecar kishte nxjerrë "fuçinë e tij të verës". Aroma e mishrave të pjekura dhe qebapëve ishte një joshje e përballeshme për dashamirët e këtyre festive. Për Pogradecin, kjo është një tradidë e lashte e qytetit. Kodra e Kalasë së qytetit dhe një pjesë nga fushat e tij mbilleshin dikur me të gjitha me vreshta dhe çdo shtëpi pogradecare në qilare mbante butet e verës së kultivuar (shumë prej tyre ishin disa kuintalshe dhe mund të ngjiteshe vetëm me shkallë).

Shumë djem të këtij e trashëguan brez pas brezi këtë traditë nga prindërit dhe gjyshërit e tyre. Vera ka zënë vend në shpirtin e qytetit. Mjeshtri i prozës shqipe, Mitrush Kuteli, mes perlave të tij këndon dhe ambientet tradicionale të këtij festimi- duke na dhënë në mënyrën simbolike të kuqen-verë, zjarin dhe gjakun që vijnë si elementë të ekzistencës.

Këngët pogradecare që këndoheshin anembanë sheshit krijuan një atmosferë vërtetë të pa zakonit në këtë fundviti. Kryetari i Bashkisë, Artan Shkëmbi, tha se, tashmë, kjo festë e verës nuk është më "Festa e Bashkisë", por ajo është festa që e organizojnë vetë Pogradecarët. Dashamirët nderuan mjeshtrin e hershëm të përpunimit të verës si Fani Naçua, Haki Haxhillari, Bardhyl Shuke (fitues i disa çmimeve edhe ndërkomatere) deri te mjeshtri me i ri i pasionuar, i cili është fitues për 9 vjet rresht, Artur Blacëri.

Nga juria e ngritur nga Bashkia u shpallën fituesit e verës së kuqe dhe verës bardhë si dhe poezinë më të mirë kushtuar verës.

Intervistoi;  
Koço PIHONI

Bardhyl Berberi



FITUESI I CIMIMIT TE VERES ME TE MIRE



# “Taxh Mahalli”, mrekullia e ndërtuar nga një shqiptar

Gjurmët e krijimtarisë së mjesh tërve shqiptarë janë hetuar deri në Indinë Veriore, ku gjatë gjysmës së parë të shekullit XVII udhëhoqi punimet për njërin nga kryeveprat e arkitekturës: konkretisht “Taxh Mahallin” e Agras në bregun e lumit Jumna. Atje ishte themeluar në shekullin XV dinastia e mogulëve nga pasardhësit e Tamerlanit dhe të Xhengiz Khanit. Kjo dinasti me gjithë luftërat dhe kryengritjet, me gjithë grindjet e pareshtura në gjirin e familjes perandorake arriti kulmin e fuqisë politike dhe lulëzimin më të madh artistik në kohën e shah Xhahanit, i cili ishte prototipi i sundimtarëve mogulë. Ambicia e tij arriti deri në atë pikë sa të ngrinte krye kundër babait të vet, Jahanhinit, që e rrëzoi nga fronti dhe e burgosi. Shah Xhahani përpiqej ta zburonte jetën e tij të zymtë me vepra artistike. Në kurtin e tij gëlonin poetët, muziktarët, dramaturgët, piktorët etj. Udhëtimpërshkruesi venecian Nikolo Manuci, i cili pati vajtur në kurtin e mogulëve, tregon se shah Xhahani organizonte vit për vit nga një panair 8-ditësh në Pallatin Perandorak, ku merrnin pjesë femrat më të bukura, të zgjedhura nga një komision ekspertësh.

Në këtë klimë “dashurie” lëngonin vetëm princeshat e familjes mbretërore, të cilat thjesht për një “strategji” të shahut nuk mund të martoheshin, sepse dhëndurët lakmitarë mund të sillnin ngatërresa, përçarje e pjesëtim të pasurisë. Princeshat e gjora veniteshin e mbeteshin lënesha. Shah Xhahani ishte dhënë veçanërisht pas ndërtimeve, siç dëshmojnë ndërtesat e bukura e me shije të stërholluar që u ndërtuan në kohën e tij. Por gjithë ai shkëlqim i sipërfaqshëm nuk e mbulonte dot dhunën dhe mjerimin, as nuk e fshihte dot shtypjen dhe shfrytëzimin e masave të gjera popullore nga një pakicë feudalësh apo tregtarësh të pasur.

Në vitin 1629 shah Xhahani u prek thellë nga humbja e bashkëshortes së tij Mumtaze Mahall që vdiq lehonë. Shahu mendoi ta përjetësonte kujtimin e saj nëpërmjet një përmendoreje madhështore, që të mishëronte bukurinë e bashkëshortes, prandaj ftoi në Agra arkitektët më të përmendur të asaj kohe. Midis mjeshtrëve që shkuan atje nga vendet e ndryshme ishte dhe mjeshtri shqiptar Mehmet Isaja bashkë me bashkatdhetarët e tij. Këta ustallarë me përvojë në teknikën e ndërtimeve ishin anëtarë të shoqatës së arkitekteve në Stamboll. Vajtën në Agra i paraqitën shahut projektet e tyre. Pasi u shqyrtuan një nga një projektet e ndryshme, shah Xhahani zgjodhi pikërisht atë të usta Mehmet Isasë, të cilin e ngarkoi me drejtimin e punimeve.



Njëzet mijë veta: zejtarë, punëtorë të zgjedhur nga të katër anët, punuan plot 20 vjet rresht (d.m.th. nga viti 1630 deri në vitin 1650) për realizimin e kësaj veprë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të kryemjeshtrit Mehmet Isaja, i cili kontrollonte zbatimin e projektit. Edhe lënda e ndërtimit: mermeri, gëlqerja, rëra e kuqërremtë, koral, sedefi, kristali, u sollën nga të katër anët. Për të gjitha këto u shpenzuan disa miliona rupi.

“Taxh Mahalli” u ndërtua mbi një terracë në bregun e lumit Jumna, 7 km larg Agras. Planimetria e kësaj përmendoreje ka trajtën e një katrori me qoshe të prera. Të katra faqet i ka të njëjlojta. Në të katra skajet e bazamentit ka nga një minare prej mermeri të bardhë. Përveç këtyre në krahët e “Taxh Mahallit” janë dhe dy godina: faltarja dhe bujtina për pelegrinët, ndërtuar me zhur të kuqërremtë dhe të mbuluar me kube prej mermeri të ndritshëm. Përpara mauzoleut shtrihet parku i bukur me pellgje e shatërvanë. Tërë ky ansambël monumental me plane të përpjesëtuara e të drejtpeshuara është realizuar në mënyrë të përsosur. Gjerësia dhe lartësia e mauzoleut në relieft është 57 metra, kurse lartësia e përgjithshme e “Taxh Mahallit” nga niveli i tokës deri në majën e kubesë qendrore arrin 74 metra. Kjo kube qendrore është e rrethuar nga katër kube më të vogla. Gjithashtu brendia e këtij mauzoleu të ndarë në katër kthina të mëdha të mahnit me harmoninë e përpjesëtimeve, tra-

jtave e ngjyrave. Nëpërmjet dritareve të daluara në mermerin e kubesë qendrore depërton përbrenda një dritare kaltërore, që tretet me tonet e zburimeve të mozaikut, agatit, koralit etj. Qivuret e dy bashkëshortëve janë vendosur pas një ndarëseje të lahurishme. Një nga çuditë e këtij mjedisi është dhe cilësia akustike: aty çdo zë e çdo tingull kumbon gjatë për disa sekonda.

Kryemjeshtri gjenial i kësaj veprë eklektike ka ditur të ujdisë përvojat dhe stilet e mjeshtrëve të ndryshëm, bashkëpunëtorëve në një tërësi të harmonishme. E me të vërtetë, duke soditur pamjen e “Taxh Mahallit” të pushton një mbresë harmonie dhe qetësie: ajo ndërtesë mermeri, që zbardhëllen midis qiparisave të lulishtes, ka diçka të mahnitshme në përpjesëtimet sqimatare të vijave nga baza e saj deri te maja e kubesë qendrore. Me të drejtë ky mauzoleu vlerësohet jo vetëm si përmendoreja më e shkëlqyer e Agras, por madje admirohet si një ndër kryeveprat më të bukura të historisë së arkitekturës botërore. Jo më kot u mbiqajit “përmendore e mrekullueshme e dashurisë dhe besnikërisë bashkëshortore”.

Vlerat artistike të “Taxh Mahallit” nuk qëndrojnë vetëm në drejtpeshimin e përmasave të harmonishme apo në hijeshinë dhe begatinë e zburimeve, por qëndrojnë njëkohësisht në mjeshtrinë e përsosur të realizimit dhe në unitetin e mendimeve: aty janë shkruar më së miri përvoja e lartë shkencore me prirjen artistike dhe me

frymëzimin poetik.

Trajtat arkitektonike me pastërtinë dhe me qartësinë e linjave përkatëse e nxjerrin edhe më në pah zburimoren e stërholluar, që e vesh ndërtesën me një bukuri të pasqore. Vetë cilësia e lëndës së ndërtimit ndikon në mbresat që ushtron pamja e kësaj kryevepre: ngjyrat e ëmbla të mermerit me ndryshimet e nuancave sipas kohës i japin trajtave të kësaj përmendoreje një lehtësi të veçantë e, si të thuash, të ajrshme. “Taxh Mahalli” duket veçanërisht tërheqës pasditeve, kur bie vepa e kur mermeri nxjerr në pah disa nuanca të këndshme në ngjyrë trëndafil, por edhe më tërheqës duket netve me hënë të plotë: atëherë ka një pamje përrallore. Soditja e kësaj kryevepre lë mbresat e dëgjimit të një muzike të papërsëritshme. Bukuria e këtij mauzoleu kurorëzohet nga natyra me kushtet që e rrethojnë.

Për sa i përket jetës së kryemjeshtrit të kësaj kryevepre hëpërhe kemi fare pak njoftime. Pasi krijoi këtë kryevepër të amshuar, rrezikoi të pësonte fatin e sa e sa arkitektëve të mbuluar nga anonimia. Historianët e artit kanë shfaqur mendime dhe hamendësime të kundërta për kombësinë e tij gjoja persiane, indiane, bizantine, italiane etj., por sipas të dhënave dokumentare, që u zbuluan vitet e fundit, del se usta Mehmet Isaja ishte shqiptar nga Opari malor i krahinës së Koçës. Për këtë dëshmon Xhaferr Çelebiu, në një dorëshkrim turqisht me titull “Broshura e arkitekturës”, e cila ndodhet në thesarin e bibliotekës së pallatit “Top-kapi” të Stambollit. Me sa duket, “Taxh Mahalli” është vepra e fundit e këtij mjeshtri - usta Mehmet Isaja. Gojëdhëna tregon se, kur e pa shah Xhahani këtë veper të përfunduar, u kënaq shumë dhe u mburr se një përmendore kaq të përsosur, një parajsë e këtitillë mund të ndërtohej vetëm në Agra, ku çmoheshin artistët së bashku me veprat e tyre... Pastaj thuhet se shahu e paska pyetur usta Mehmet Isanë nëse mund të ndërtonte prapë një tjetër veper si kjo. Kur kryemjeshtri iu përgjigj: “Po, ndosh-ta edhe më të bukur”, shah Xhahani u turbullua. Si shpërblim për gjithë këtë punë dha urdhër të burgosej menjëherë kryemjeshtri fatkeq dhe të verbohej. Kështu, usta Mehmet Isaja nuk do të kishte më asnjë mundësi të ndërtonte prapë diçka të bukur.

Më vonë, në shtator të vitit 1657, kur u hap lajmi se shah Xhahani ishte sëmurë rëndë, njëri nga djemtë e tij, gjakësor e bir gjakësori, i cili priste me padurim ditën për ti zënë vendin në fron, sulmoi Agras, e pushtoi me forcë dhe, pasi e shfronësoi të atin, e burgosi në kështjellën e atij qyteti, ku ngrysi jetën e tij me gjithë ambicien dhe shijen e hollë artistike duke soditur nga dritarja e burgut me orë të tëra “Taxh Mahallin”. Vetëm kur vdiq shah Xhahani, pas tetë vjetësh (më 22.01.1666) ia nxorën kufomën nga burgu dhe e varrosën në “Taxh Mahall” pranë bashkëshortes së tij.

Usta Mehmet Isaja nuk është i pari dhe as i vetmi artist shqiptar që punoi e krijoi larg atdheut, por është një ndër sa e sa mjeshtrit e dalë nga gjiri i popullit tonë, që pasuruan fondin ndërkombëtar me kryevepra

Përshtatur për gazetën  
Istref HAXHILLARI

## SI U PËRHAP KRISHTËRIMI NË MOKËR

Krishtërimi lindi në pjesën lindore të Perandorisë romake (Palestinë) dhe u përhap në fillim në shtresat e varfëra. Në shekullin IV pas lindjes së Krishtit u shpall fe shtetërore në Evropë. Mbështetet në besimin te figura mitologjike e Jezu Krishtit dhe është kodifikuar në Biblën. Janë kryesore tri degë: katolicizmi, ortodoksizmi, dhe protestantizmi. Në Shqipëri, krishtërimi njihet vetëm në dy degët e tij: ortodoksizmin dhe katolicizmin. Filloi të përhapet në Iliri

që në shekullin e I pas Krishtit. Me ndarjen e perandorisë romake (395) pas Krishtit në dy pjesë, të lindjes dhe të perëndimit, Shqipëria kaloi në atë të lindjes. Në të mbetën të dy degët e krishtërit, por ortodoksizmi përfshiu pjesën dërmuese të popullsisë. Nga gjysma e parë e shekullit VIII, ortodoksizmi shqiptar filloi të vërej nga Patrikana e Kostandionopojës. Në shekullin X, u krijua kryepeshkopata e Ohrit, nga e cila varshin peshkopatat e Shqipërisë Jugore, (përfshi edhe

të krahinës Mokrës) ndërsa të tjerat nga mitropolia e Durrësit. Me suprimimin e kryepeshkopatës Ohrit (1767), kisha ortodokse rikaloi nën varësinë e Patrikanës së Stambollit. Gjatë mesjetës, megjithë katolicizmi u forcua me urdhërat benediktine, dominikane dhe françeskane, në Shqipëri ai mbeti në gjendje inferioriteti në krahasim me ortodoksizmin dhe varej nga Vatikani. Të dy kishat u paguanin taksat organeve më të larta të tyre. Me pushtimin osaman dhe përhapjen e islamit, krishtërimi shqiptar pësoi goditje të rëndë ekonomike e politike.



# AMANETI

Sipas bisedave me mikun tim, të ndjerin Behar Shtylla nga TOMI MATO

**T**mrat e industrisë së rëndë krijojnë mbi Pragën e artë një shtresë tymi aq të trashë sa nuk dukej dielli. Përshtim bëhej vetëm kur „qentë” universi ose mbulonte qytetin jorgani bardhë në dimër. një ditë korriku i vitit 1956, së bashku me bashkëstudentin (regjisorin) Hysen Hakanin vendosëm të lundronim me vapor nëpërmjet „Lumit Vltava”, deri në kështjella përrallore e Karlit IV (pesë km. larg). Që atje na puthnin fytyrat rrezet e diellit. Duke mbyllur derën e dhomës ku banonim ushtoi zëri altoparlantit: „Pane Mato u telefonua” – (Zoti Mato në telefon). Mora receptorin dhe pyeta:

- Prosim? Gdo vola? – (Ju lutem, kush telefonon?)

- Mora përgjigjen:  
- Koço Thoma Priifti. - U nemita.  
Mblodha veten dhe fola:  
- Urdhëroni, shoku ambasador!  
Me dashamirësi më njoftoi:  
- Të pres në zyrë. Mos u vono.  
- Erdha, shoku ambasador. – Iu ktheve

Hysenit: „Më kërkoni. Vizitën për të na puthur fytyrat rrezet e diellit, e lëmë për një herë tjetër”. Trokita në portë. Sa dëgjova fjalën „urdhëroni”, rëndova dorezën. Brenda ishin gjashtë burra të panjohur.

U befasova. Shoku Koço m’i prezantoi:  
- Shoku Behar Shtylla ministri ynë i Jashtëm (përsëritja me kokë). Më prezantoi dhe me katër shokët e tjerë, të gjithë kuadro të lartë partie).

Të pestit i dha theks të veçantë:  
- Shoku është Rebani Shehu. Të pestë janë të sëmurë, kanë ardhur për t’u kuruar. Epikrizat i kanë me vete. I ka diagnostikuar doktori i udhëheqjes, Fejzi Hoxha. Shtroji nëpër spitale. Pres të më informosh.

U ngrita. Iu drejtova  
- Shoku ambasador detyrën e kam të qartë, mund të largohem?

Ma përsëriti:  
- Dua sa më parë informacion.

E sigurova:  
- Si urdhëron. - Dolëm.

Katër diagnostikimet e bëra nga Dr. Hoxha, rakordoheshin plotësisht me analizat e laboratorëve çekoslovakë:

Rebani Shehu ishte diagnostikuar në Shqipëri: „Vuan nga nervat, nuk ishte e saktë”. Komisioni më rekomandoi: „Shpjegje në klinikën infektive, ata janë kompetentë të kësaj sëmundjeje”. I shpura. Si i bënë dy herë analizat, më njoftuan:

„Zoti Shehu ka sëmundje ngjitëse, të rrezikshme”.

„Zhlukenkë”-Botkin-Verdhicë”.

Meqë e shoqërova më bënë një inxheksion. U shtrova.

Kur hyra në ambasadë çaloja.  
Shoku Behar, i shokuar, më pyeti.

-Ti ike mirë ç’ke?  
Ia tregova shkaku. U shqetësuan.

U ngritëm dhe shkuam në spital.

Biseduam me drejtorin. Na siguroi se do ta nxirrte nga klinika të shëruar. Me Rebaniun biseduam, ne poshtë ai lart në dritare. Duke u kthyer, Behari më njoftoi:

-Shoku Tomi dhe unë kam Valin, gruan të sëmurë. Do më ndihmosh ta shtroj?

Duke kthyer kokën nga ambasadori iu përgjigja:


-Shoku Behar në Pragë dhe shumë studentë shqiptarë, në qoftë se më ngarkohet mua kjo detyrë jam gati t’ju ndihmoj.

Zbritëm në ambasadë.

Valentina u shtrua, u kurua, u shërua. Gjatë kësaj kohe pata rastin me shokun Behar të pi kafe, të vizitot qendra të rëndësishme kulturore dhe artistike të dilyn shetitje.

Më informoi se kishte mbaruar studimet e larta në Itali për gjuhë-letësi. Njeri me kulturë. Inteligjent, me shije estetike. U miqësova. Nga kultura e tij njoha më mirë Danten, Bokaçion, Goldonin, etj. Meqenëse tregimtari madh pogradecar Mitrush Kuteli kishte grumbulluar krijimtarinë e Fan Stilian Nolit dhe shqipërimet e disa veprave me famë botërore në librin „Mall e brengë” (pajisur me një vështrim kritik shkencor), një ditë rrëshqita pak nga tema që të hyja më pas në temë. E pyeta:

-Shoku Behar ne s’kemi marrëdhënie diplomatike me Amerikën.



Noli dhe B. Shtylla

Juve kini qenë në Amerikë? Po të hyjë pyetje ime në politikë, mos ma shuani kureshtjen.

Buzëqeshi. Ishte në humor. M’u kundërvu:  
-Shoku regjisori i ardhshëm, ç’të intereson ty kam qenë apo s’kam qenë në Amerikë? Apo ke babanë atje?

-Jo. Im atë ka qenë dy herë në Boston por u kthye që para luftë.

Behari nguli këmbë:  
-Atëherë, ç’të shtyn të dish kam qenë apo jo në Amerikë? Tregohu i sinqertë! Nuk do më vijë mirë po të ma dredhish.

Kisha krijuar idenë që Behari ishte inteligjent, t’i lexonte mendimet që kishe në kokë. Iu hapa:

-Hirësia e tij, Fan S.Noli, ka disa miq në Pogradec. Kur erdhi për

zgjedhjet, më 25 gusht dhe 8 dhjetor 1923, bashkë me zotërinjtë Kol Rrodhen dhe Beqir Rusin nuk hëngri dhe nuk fjeti te bejlerët, por në shtëpinë e Koçi Tushit. Vjehrra ime ishte mbesë në atë shtëpi, e kishte parë me sytë e saj Hirësinë duke bërë tualetin e mëngjesit... - Ndala, sikur e humba fillin e mendimit.

Behari pyeti:  
-S’të kuptova, ku e kishe fjalën?

U ndërgjegjësova. Kërceva i lumturuar:  
-Desha të di i kishte rënë në dorë libri „Mll e brengë” apo jo? Këtë desha... -

Më dhe informacion të saktë.

-Ne s’kemi marrëdhënie diplomatike me qeverinë amerikane, dua të di kini qenë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Po të kesh qenë, do isha kurioz për disa gjëra. Shpresoj s’janë politike, më shumë janë letrare.

I vetëdijshëm dhe pa ndrojtje, më informoi:  
-Pas luftë, peshkopi grek Kotoko dhe një senator amerikan, Pepper, i kërkonin qeverisë amerikane që Gjykoakra dhe Korça t’i aneksoheshin Greqisë. Kolonia shqiptare s’i përballonte dot argumentet e lobit grek, ndaj i kërkoi

qeverisë amerikane pranonte të shkante një delegacion: Kryetari Tuk Jakova, anëtar Behar Shtylla, ministër pa portofol, Drejtori i Ministrisë Shëndetësisë Dr. Sherif Klosi dhe njohësi gjuhës angleze Alqi Kristo. Më 17 qershor 1946 delegacioni u nis. Kur arritëm në Amerikë, mjetet e propagandës, radiot dhe shtypi, bënë zhurmë të madhe. Ndërhyra menjëherë e pyeta:

-Me Hirësinë e tij, Fan S. Nolin, u takuat?

-Shqiptari i parë që erdhi nga Bostoni e na takoi ishte Fan Noli. Burrë i mençur, atdhetar e patriot i madh dhe diplomat e orator i shquar. Ruheshja se mos shkisja në çështje politike, desha të dija kuriozitetet letrare, artistike, ndaj pyetjen e parë ia bëra:

-Personalisht e kisha lexuar „Historinë e Skënderbeut dhe librin „Mall e brengë” ku shkruantari ynë i madh, Mitrush Kuteli, kishte mblodhur krijimet dhe shqipërimet më të bukura (shoqëruar me një vështrim kritik). Desha të dija: -I kishte rënë në dorë vepra me krijimet e

shqipërimet e tija „Mall e brengë”.

-Po.  
-Mitrushi ia kishte dërguar?

-Jo.  
-Po kush? Në rast se nuk hyn në sekrete shtetërore tregomani, ju lutem?

Më tha të vërtetën e kulluar:  
-Miku i tij që përmende, Koçi Tushi, së bashku me disa vepra të tjera të Mitrushit. I kishte lexuar të gjitha dhe kishte mendimin se: „Mitrushi është kritik me shijë, shkruantari me taban e gjuhë të pastër shqiptare dhe një nga shkruantaret modernë të letërsisë artistike”.

Veç këtyre, kujtoj që Behari më tha: „Kuteli për mua është talent”.

Nga leximi veprave „Netë shqiptare”, „Kapllan Aga i Shaban Shtatës”, „Ago Jakupi e të tjera rrëfime”, „Sulm e lotë” kam krijuar bindjen e patundur se nga shkruantaret aktualë shqiptarë madhori Mitrush Kuteli për mua qëndron në ballë. Është mjeshtër i tipizimit të karaktereve dhe krijimit të aftësive bindëse në kuvende popullore. Më tërheq atmosfera e bisedave, sa shumë herë harroj që i lexoj në libër e transformohem si personazh i vërtetë në ngjarje. Ka dhe humor të mençur. Personalisht e kam për zemër humorin. Falë telepatisë, m’u kujtua kjo histori: „Në një darkë që shtruan miqtë shqiptarë për nder të delegacionit tonë, Nolin e caktuan të ishte drollibashi. Me gjithë që s’pinte dollinë e përziente, bujarinë shqiptare me zakonet amerikane. Ishte artist. Dollitë i lezetonte me shakara. Na kallëzoi se fyllit i binte me shumë ëndje. Kur erdha në Shqipëri e mora me vete. Kur u bëra kryeministër, një ditë isha i mërziutur dhe mora fyllin e ta largoja mërzinë, njëri më kishte dëgjua. Menjëherë kishte hapur fjalën: „Ç’presim nga një qeveri ku kryeministri i bie fyllit?”

Noli i pari gajasi nga kjo mesele, pastaj mbajtëm brinjët gjithë të tjerët. Kjo shaka më nxiti akoma më shumë t’i lutem shokut Behar:

-Bëni të pamundurën që të vijë hirësia e tij Noli në Shqipëri e të takohen këta dy gladiatorë të letrave.

Duket sikur propozimin tim e mori në konsideratë. Më dha shpresa.

-Miku im, po afrohet 50 vjetori pavarësisë. Noli është nga demokratët e parë revolucionarë që triumfoi Revolucioni Demokratikoborgjez në qershor të 1924. Do ta ftojë qeveria jonë. Ke për të parë, do takohesh.

Gulçova me gjithë shpirt e zemër:  
-Ah, sikur t’i shikoj të dy të përqafohen!

Pas 50 vjetorit të pavarësisë, në pushimet verore, ishte viti 1964, e takova mikun tim, Behar Shtyllën (Ishte akoma ministër i Jashtëm). U ulëm në lulishten e Turizmit. E ngacmova:

-Kujtoj në Pragë, më 1956, më dhatë shpresa se qeveria do ftonë për festën e 50-vjetorit Hirësinë e tij Fan S. Nolin... -

Më ndërpriu e informoi:  
-E ftuam, por s’i dha vizë qeveria ameri-

kane. E dyta, kish qenë i sëmurë. Megjithëse kisha krijuar imunitet se Behar Shtylla s’dinte ta dridhte, këtë lajm ogurzi ma njoftoi si me dredhi. Kisha dëgjuar edhe nga një mik tjetër që Enver Hoxha s’kishte dashur t’i dërgonin ftesë. E s’i dërguan.

Herën e fundit, shokun Behar e takova në Mokrën e Sipërme; ishte bashkë me shokun Llambi Gegpriftin.

U mblodhën fshatarët e Mokrës së Sipërme dhe të Poshtme, Trebinjë.

Miting i madh. E lamë të takoheshim në mbrëmje dhe në mëngjes.

Më ngarkoi ta takonte dhe profesor Lasgush Poradecin. (Këtë histori e kam shkruar në librin tim „Të vërteta e të pathëna për Lasgushin”. Behar Shtylla kërkon Lasgushin. Si zakonisht, shoku Behar ndiente kënaqësi kur bisedonim për Fan Nolin. E adhuronte. Kam thënë, si diplomat, atdhetar dhe shkruantari. Nisur nga kjo ndjesi, i drejtova këtë pyetje:

-Shoku Behar, kur e takuat për herë të fundit mikun Tuaj, Hirësinë e Tij Nolin? Kishte një memorie të çuditshme.

U përgjigja pa u menduar:  
-Më 20 dhjetor 1964.

-Në Boston?

-Nju Jork.

-Erdhi t’ju takojë?

Sikur hezitoi të më tregojë, por mbas një pauze vendosi:

-Tomi, miku im, qysh në Pragë krijoja idenë se nuk jini llafazan, nuk blini dhe shisni mendime. Më pëlqeni, si karakter. Duket që rridhni nga familje fisnike.

-Punëtore. Babanë e kam pasur murator, por me nder në ballë. Pa shkollë ishte, por kur beti vllahi dhe Amerika iu bë shkollë. Jeta e kishte mësuar e vazhdimisht më këshillonte:

„Kurrë mos ëndërro të krijosh lumturi për vete duke i bërë keq tjetrit”. Më kupton biri im? Rëndë mallkimi më i rëndë në jetë në qoftë se bëhesh spiun!” Këtë amanet të babait e kam busull në jetë. Ma shtrëngoi dorën, i bindur që di të mbaj fjalën e dhënë.

Vazhdoi:  
-Nolin e kam takuar për herë të fundit, siç të thashë, më 20 dhjetor 1964. Unë kisha vajtur në Nju Jork për sesionin e zakonshëm të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara. Në rend të ditës ishte kërkesa e Shqipërisë për vendosjen e të drejtave të Republikës së Kinës në OKB. Kërkesën e kishte bërë përfaqësuesi shqiptar, shoku Halim Budo. Një ditë më përpara na ftoi Noli në Boston.

Lajmëruam që s’kemi mundësi.

Ai na njoftoi që më datën 20 dhjetor 1964, ora 13 ta prisnim në stacioni i trenit Pensilvanisë Nju Jorkut, se do kalonte për Florida. Vajtëm, shoku Halim Budo, dy sekretarët, Sokrat Çomo, Todi Riza dhe unë. U takuam e u çmallëm.

Drekuam bashkë. Noli na informoi se kishte bërë një operacion të rëndë. Mjekët i kishin rekomanduar ta kalonte stinën e dimrit në Florida. (Atje ishte ngrohtë). I uruam shërim të shpejtë. Falënderoi dhe shtoi:

-Vëllezërit e mi, se merrni dot me mend sa shumë më ka marrë malli për Atdheun tim, nënën Shqipëri. Dua t’i takoj miqtë e mi Milto Sotir Gurën, Lasgush Poradecin, Mitrush Kutelin, Koçin e Tushit, të takoj profesorët e universiteteve, dëshiroj të bëj disa lektyra, të kuvendoj me studentët. Ëndërroj të bie më gjunj, ta puth atë tokë të shenjtë që „Është balta më e ëmbël se mjaltja”. Iu mbushën sytë me lot. Vazhdoi: „Nuk më ftuat në 50 vjetorin e Pavarësisë, ju lutem në emër të Zotit (duke u falur), po të më ftoni do shërohem. Dua ta shikoj se sa ka ndryshuar Shqipëria. Besomëni, zhur e kam zemrën. Nëmami fjalën se do më ftoni. U plaka dhe s’dihet si do më vejë filli. Kur u operova, pashë ëndërr sikur vdekja më kishte dërguar me postë „Lajm-thirrje”. U ngashërova dhe premtova:

-Të jap fjalën e shqiptarit, se shqiptari kur jep fjalën e mban. Unë do të dërgoj ftesë. Ma shtrëngoi dorën dhe më përqafoi. Mori gotën me verë të kuqe e tha: „S’do ketë lumturi më të madhe për mua sikur ta çukas gotën me verë me miqtë e mi të Nëna ime Shqipëri. Dhëntë Zoti, ta shikoj këtë ëndërr. Gëzuar!”

Kishte zavrall në shpirt, ankth deshte ta nxirrte. Prapë e mori fjalën: „Po afron koha e ndarjes. (Vijon ne numrin tjetër)





## MOKRA TRIME

POEZI NGA  
PËLLUMB XHELOLLARI

### MOKRA TRIME

Do këndoj për Mokrën time  
Legjendaren edhe trime

Mokër me gjerdan prej ari  
Me trima si Gjok Shqiptari

Mokër e luftes dhe e punës  
Trime në ballë të furtunes

Bloje grurë per kulaç  
Hasmit i ke dhënë kërbaç

Blojte gurë e grurë  
Mokër që s'harrohesh kurrë

Mokër me zemër të madhe  
Djem azganë, çupa sorkadhe

Mokër moj zemër flori  
Prite mikun në shtëpi  
Me shtatedhjetë ngrite doli

Nga lenia gjer në Ohër  
Ty të thonë nëna Mokër

Mokra jone në moker gur  
Mokër që s'harrohesh kurrë!

### MOKRARES TRIME

Moj çupë e Homezhit  
Mbusnje ujë në krua  
Dashuri e parë  
Që çeli me mua

Të dua aq shumë  
Sa ti edhe mua  
Shumë vite ikën  
Zjarri nuk u shua

Ti ishe mokrare  
Kaçurrelat dashur  
Si shqerra manare

Tiranë më 08 dhjetor 2009

### ÇUPA ME MËSALLË

Ky burim i fshatit  
Me një syllynjar  
Mbushte ujë e para  
Çupa me mësalë

Refreni  
Mësalë ma kishe,  
Aman me dy faqe,  
Mos kështu moj çupë,

Mos moj se na plase.

Seç u bëje lajka  
Djemulive radhe,  
Asnjërit s'i thoshe  
Të kam në mësalë.

Refreni  
Mësalë ma kishe,  
Aman me dy faqe,  
Mos kështu moj çupë,  
Mos moj se na plase.

Seç i merrnje kovat  
Dëng e mbushur plot  
Djemuri e fshatit  
Për ty derdhte lot

Refreni  
Mësalë ma kishe,  
Aman me dy faqe,  
Mos kështu moj çupë,  
Mos moj se na plase.

### UNË TË PATA THËNË

Aty nën mezhde  
Shqerrat i kullosnje  
Ca fjalë nëpër dhembë  
Mua çpo mi thoshje

Refreni  
Unë të pata thënë,  
Se shumë të dua,  
Me gjithë bukurinë  
Dhe nazet e tua.

Të thërriti nëna,  
Ti nuk u përgjigje  
Qeshnje, mumurise,  
Drejt meje po vije.

Refreni  
Unë të pata thënë,  
Se shumë të dua,  
Me gjithë bukurinë  
Dhe nazet e tua.

Erdha të takova,  
Faqet digjnin shpuzë,  
Të putha në ballë,  
Të putha në buzë.

Refreni  
Unë të pata thënë,  
Se shumë të dua,  
Me gjithë bukurinë  
Dhe nazet e tua.

Tiranë më 26 dhjetor 2009

Pellumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"  
Istref HAXHILLARI, Zenun FERRO, nënkryetarë të shoqatës  
Zabit Çuku, sekretari i shoqatës  
Kryeredaktor Flori SLATINA  
www.poradeci.com/mokra  
gazetamokra@yahoo.com, florislatina@yahoo.com

Elbasani merrte frymë me zor shtrirë në dys hekun pafund që fillonte aty ku ndahej nga Librazhdi e vazhdonte gjer afër Cërrikut. Shpërndarë në sipërfaqe të madhe nuk i ngjante asnjë qyteti tjetër, me shtëpi karakteristike rrethuar nga avlli, kopshte e pemë të shumta mbirë gjithandej në tërë sipërfaqen e sheshtë të qytetit.

Banorët e tij babaxhanë, të shtruar e të gjendur për njëri - tjetrin, e donin jetën dhe gëzimet e saj, ndaj të shumtën e kohës ishin të qeshur, tërë gaz. Këndonin kudo ato këngët e tyre të thjeshta dhe aq të bukura, sa të vinin në mendime të thella për këtë të uruar botë që na ik shpejt si pa kuptuar.

Vetëm fushë ngado të hidhe sytë, qyteti s'kishte asnjë kodër sado të vogël. Në këtë pikë nuk kishte tjetër të ngjashëm me të. Qytete të mëdhenj nëpër botë kanë kodra e brigje, vende të ngritura, po Elbasani nuk kish asnjë të tillë.

Shkumbini që fillonte diku malet e Mokrës, merrte fuqi, fryhej e zmadhohej nga të tjerë lumenj e përrenj pa fund përreth tij. Kur vinte në Elbasan, i fuqishëm sa më s'ka, ngjasonte me mbretërit e kohëve të shkuara që nuk duronin t'u kundërshtonte askush se bëjnë hatanë.

Lufta e njerëzve me lumin e vjetër sa bota, herë - herë ashpërshej shumë, merrte përmasa të çuditshme si askund tjetër. Në kohët e vjetra banorët i faleshin Zotit nëpër kisha e xhami, luteshin me gjithë shpirt t'i pakësonte fuqinë shkatërruese përbindëshit që i përndiqte pa mëshirë vit pas viti. Më pas përgatisnin thasë me baltë e rërë, gurë të mëdhenj rrokullisur nga faqet e maleve përgjatë lumit, i hidhnin nëpër valët e egërsuara. Veç këtij ceni të madh, lumi bënte punë të mira, i ndihmonte banorët në ca anë të tjera. Verës së thatë të nxehtë si rrallë tjetër elbasanasit freskoheshin anës tij, ndërsa kopshtet dhe arat nuk prodhonin asgjë pa ujë e bekuar të Shkumbinit.

Njerëzit ngritën në kohët e shkuara një vend të veçantë larg lumit të harbuar, e rrethuan me mure të lartë e gurë të mëdhenj, u strehuan aty, të sigurt. Kalaja e Elbasanit ngritur në mes të fushës në sipërfaqe të madhe ngjante me një qytet të vogël brenda qytetit të madh. Banorët e kalasë ishin të pëzgjedhur, më elbasanas e ata jashtë saj, më të ditur e më të vjetër. Ndihehin krenarë, mbaheshin rëndë, visheshin me sqimë, kriheshin sipas modës së fundit. Të tjerët i merrnin për model, përpiqeshin t'u ngjanin. Në mënyrë të veçantë gratë e Kalasë, të hijshme, të bukura prej natyre, stolisur sipas gustos më të fundit, bënin përshtypje të madhe. Gjuha e tyre bënte beli:

- Zonja Sofi, mirmëngjes, si e kaluat natën? - pyeste komshia.  
- Oh, ç'surprizë zonja Leni, fale-minderit, po ju si keni qenë?

Biseda të tilla, elegante për kohën, u bënin përshtypje grave të tjera që përpiqeshin t'i imitonin ato të kalasë.

Ishte moti kur Isuf Myzyri, plakur shumë, po i afrohej fundit të jetës dhe fama e tij lartësuar përmbi Malin e Vashës. Këngët që thurte bëheshin më të dhimbshme, më prekëse e tunduese, me shumë filozofi brenda. Muzika e tij kishte marrë përmasa hyjnore.

Herët në mëngjes, me shtatin e vogël, rrëgjuar nga pleqëria dilte te porta e shtëpisë. Shoqëruar nga violina e ngrënë prej kohës, ulëj nën fikun e moçëm, me degët ndehur nëpër tërë bahçen. Shumë elbasanas, me plagë të rënda të shpirtit, të vjetra e të reja, prisnin të dilte mjekun

Tregim nga Istref HAXHILLARI

## Magjia e këngës



e rrallë, i aftë të shëronte shformime të rënda të zemrës së njeriut si askush tjetër.

Ashtu doli edhe atë ditë vere. Rrudhat harbonin pa mëshirë nëpër fytyrën e lodhur. Vështroi nga porta gjysmë e hapur.

Një djalë jo fort i ri, aty te të dyzetat, me shprehje të dhimbshme në fytyrë, hapi me vërtik portën e avllisë dhe hyri në kopshtin e Myzyrit. Burri i hijshëm me trup atleti dhe kaçurrelat e pabindura që i binin mbi sy, dukej në ditë të hallit. Bota kishte humbur shkëlqimin, ngjyrat nuk ekzistonin. Një merak i pakuptuar e mundonte tmerrësisht. Me përkulje e nderim të veçantë iu drejtua plakut çudibërës.

- Usta, kam hall të madh, po më çahet zemra, po më lot mendja, nuk fle as natë, as ditë kam tre javë të tëra. Më bëj derman.

Plaku vuri dorën mbi sy, të mbrohej nga dielli. Vështroi për një çast dhe kuptoi përnjëherë hallin e madh të tjetrit. Më shumë se fjalët i bënte përshtypje sytë e tij të kapitur, rrethuar me shirit të bronzit anash. Pikasi hallin e rëndë, ndjeu dertin e pazakonë të atij burri të ri bërë më dysh nga pesha e barrës së madhe.

- Si të quajnë, ç'brengë ke?  
- Më thonë Mustafa. Dudia më braktisi. Prej tre javësh ka zënë një tjetër, nuk më dëgjon, nuk e prekin lotët e mi, më përbuz. Harroi dhjetë vite dashuri sikur nuk kanë qenë kurrë.

- Të ka dashur me të vërtetë?  
- Lonte mendsh pas meje, nuk duronte ditë pa më parë, tani përnjëherë u largua. Mos i kanë bërë magji?

- Ik o bir, pas një jave si sot eja. Mos i shko prapa, duro, qëndroji larg Dudisë, sillu sikur nuk të bën përshtypje, thyeja zemrën.

Pas një jave Mustafai mori ilaçin e ustait, atë këngën e jashtëzakonshme që përjetësoi brengën e shpirtit dhe dermoi zemrën e gruas së pabesë:

Të desha më hakikat  
Të pata mike për jetë  
Mirpo paskam qenë pa fat  
Ma punove pa të drejtë  
\*\*\*

Përmbi Elbasan dielli ndriste me shkëlqim verbues. Të nxehtëit përhapej ngadalë, i sigurt rrugëve të pluhurosurat që qytetit të madh. Diku u pa të bariste një grua e re, me shtat të derdhur, kryezbuluar sikur donte të sfidonte temperaturat e larta të atij korriku faqezjarr. Njerëzia strukur

nëpër qoshe dhe hajate e vështroin të magjepsur atë bukuri të rrallë, e ndiqnin me sy për një copë herë të gjatë derisa silueta e saj e mjegulluar zhdukej pas brryllit të rrugës. Kur hyri te porta e Kalasë, kalimtarët e rrallë dalluan brenda atij kurmi të bukur Dudinë e famshme. Të pakët ishin ata që e njihnin më parë këtë grua të hijshme si pak të tjera në Elbasan. Kënga që kishte dalë para pak kohësh e pati nxjerrë përnjëherë nga fshehtësia në dritën e diellit. Shumë shpejt emri i saj zuri të qarkullonte gojë më gojë dhe turmat e njerëzve, madje edhe atyre që e patën njohur më parë e ndiqte me vështrim nga larg, sikur të që një qenie jashtëtokësore ardhur befas në qytetin e tyre.

Ajo e dëgjoi këngën për herë të parë në një dasmë të Kalasë. Këngëtarit këndonte dhe qante. Lotët pikonin mbi telat e violinës që vajtonte atë dashuri të madhe. Pas tij rrinte i hutuar një burrë i parruar, pakrehur që nuk shikonte asnjëri përveç këngëtarit dhe violinës së tij. Burri nuk qante, madje dukej se asgjë s'kuptonte. Me vështrim budallai vetëm ndiqte melodinë dhe i thoshte këngëtarit të filonte prap, kur ai sapo e kishte përfunduar. Dudia nuk e njohu në fuillim burrin e parruar e të palarë po zemra e ndjeu e para dhe i buçiti me forcë si një shqisë e pakuptuar. Gruaja e hijshme vështroi pak me vëmendje dhe dallooi prapa asaj veshjeje të përcudnuar Mustafanë e bukur si dritë. Iu muarr mentë dhe pas një çasti u shtri e zalisur në mes të atij grumbulli dasmorësh. U ndërpre hareja, një hije trishtimi ra mbi tërë ahengun. Disa po mundoheshin të sillnin në vete gruan pa ndjenja. Dikush e njohu dhe thirri me të madhe:

- Dudi!  
Burri i parruar, shastisur pas këngës dhe këngëtarit, u zgjua përnjëherë nga tingulli i mprehtë i zërit që shqiptoi atë thirrje mallëngjyese, sikur erdhi në vete nga një gjumë i gjatë. U ngrit në këmbë, u turpërua për herë të parë pas aq ditësh nga veshja zhelane, çau me vështirësi grumbullin e njerëzve dhe u gjend pranë gruas që filloi të vinte në vete. U sul e mori në krah, e afroi pranë. U deh nga aroma e harruar prej aq kohe. Lotë të rëndë burri shpërthyer me zhurmë e potere. Dudia ia mori kokën rrethuar nga kaçurrelat e dendura të palara e pakrehura dhe ia zhyti në gjoksin e saj të hatashëm. Nga gryka e tharë i doli një tingull i çjerrë:

- Paskam qenë në errësirë!